

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41. /2014, 53/ 16 dhe 83/18), dhe duke vepruar në bazë të njoftimit të përqendrimit të parashtruar nga Avengiro s.r.o. (Avengiro s.r.o.) me seli në Vinohradaska 1511/230, 100 00 Pragë 10, Republika Çeke, përmes avokates Tatjana Popovski Buloski nga Shoqëria e Avokatëve Popovski dhe Partnerëve nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 31.01.2024, solli

AKTVENDIM

1.Vërtetohet se përqendrimi me të cilin Avengiro sr.o. (Avengiro sro.) me seli në Vinohradaska 1511/230, 100 00 Pragë 10, Republika Çeke synon të marrë kontrollin e plotë mbi Avenga Holding SHPK (Avenga Holding S.à r.l.) me seli në 26A Bowuevard Rojal L-2449 Luksemburg, me anë të shitblerjes së aksioneve, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

2.Parashtruesi i njoftimit për përqendrim obligohet që për njoftimin për përqendrim të paguaj taksë administrative në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

3.Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje të dispozitave të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më 29.12.2023, te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), është dorëzuar njoftim i përqendrimit nga Avengiro s.r.o.(Avengiro s.r.o.) me seli në Vinohradska 1511/230, 100 00 Pragë 10, Republika Çeke me të cilën Avengiro s.r.o., do të fitojë kontrollin e plotë mbi Avenga Holding SHPK (Avenga Holding S.à r.l.) me seli në 26A Boulevard Royal L-2449 Luksemburg, me anë të shitblerjes së aksioneve.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit nga dita e pranimit të tij dhe në bazën e të dhënave të paraqitura në Njoftimin për përqendrim , shtojcat dhe anekset e tyre, konstatoi si në vijim:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

Avengiro s.r.o. është pjesë e KCCG Group, një grup investimi privat me më shumë se 6,000 punonjës, që operon në 18 vende kryesisht aktive në fushat e mëposhtme:

- argëtim dhe lojëra: funksionimi i lotarive dhe lojërave të basteve, lojërave të fatit dhe platformave të lojërave online;
- nafta, gazi natyror dhe inxhinieria: në veçanti, kërkimi i naftës dhe gazit, prodhimi dhe tregtia, shpimi dhe riparimi i puseve, ndërtimi dhe funksionimi i objekteve nëntokësore të depozitimit të gazit natyror, prodhimi dhe shitja e metanolit; në inxhinierinë mekanike, ai fokusohet kryesisht në pajisje industriale, tuba kanalesh, përbërës kanalesh dhe shtrimin e tubave për ndërtimin dhe rindërtimin e njësisve të investimit;
- teknologjia: ofrimi i shërbimeve të TI-së, investimi në start-ups teknologjike dhe kërkimi, zhvillimi dhe shitja e pajisjeve mjekësore inovative për të ndihmuar pacientët të qëndrojnë aktivë dhe të vetë-mjaftueshëm (bioteknologjitë); dhe
- pasuri të paluajtshme: zhvillim komercial dhe rezidencial.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Grupi KCCG është i pranishëm në tregun e punës me терминаlet e video lotarisë dhe teknologjitë informative përmes shoqërive të mëposhtme:

- Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit KASINOS AUSTRIA INTERNATIONAL MACEDONIJA SHPK Shkup, me veprimtari prioritare –veprimtaritë e lojërave të fatit dhe basteve;
- Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit Video Lotaria Shtetërore e Republikës së Maqedonisë - KASINOS AUSTRIA SHPK Shkup, me veprimtari prioritare - veprimtaritë e lojërave të fatit dhe basteve;
- Kinshift SHPKNJP Shkup, më parë i njohur si Seavus SHPKNJP Shkup me aktivitet prioritari - programim kompjuterik; dhe

- Shoqëria për edukim kompjuterik dhe zhvillim të inovacioneve Kinshift Academy DOOEL Shkup, më parë e njohur si qendra edukative dhe zhvillimore Seavus SHPKNJP Shkup, me aktivitet prioritar - arsim tjetër që nuk përmendet diku tjetër;
- Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime Musala Soft SHPKNJP Shkup - me aktivitet prioritar - programim kompjuterik.

Avenga Holding SHPK është një kompani holding e subjekteve të ndryshme juridike ndërkombëtare (Avenga dhe filialet e saj, së bashku „Grupi Avenga“) ofron shërbime komplekse inxhinierike softuerike, ofron shërbime komplekse inxhinierike softuerike, ofrimin e projekteve komplekse/të mëdha softuerike dhe konsulencë IT. Avenga Group është me seli në Gjermani dhe ka zyrat e tij kryesore të vendosura në Gjermani, Poloni, Ukrainë, SHBA, Malajzi, Maltë dhe Argjentinë.

Avenga Holding SHPK nuk është e pranishme në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Ана Николоска

